

NJOFTIM PËR VEND PUNE

A. Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreut V , “Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, nenit 26 “Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese”, vendimit të Byrosë nr.52 “për disa shtesa dhe ndryshime në strukturën e Administratës së Kuvendit” datë 26.06.2023, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, kreut II, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, njofton se:

Në Administratën e tij ka 2 (dy) vende të lira pune, në pozicionin: **“këshilltar jurist” në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, pranë Shërbimit të Integritetit European**

a) Kategoria e pagës II, klasa I-5

Qëllimet pozicionit të punës:

Të mbështesë në mënyrë efektive, me ekspertizë juridike të një standardi të lartë dhe profesionalizëm, Kuvendin e Shqipërisë, në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European (acquis e BE-së).

b) Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Të përgatisë mendimin e specializuar juridik të kërkuar nga Drejtori i Shërbimit të Përafrimit për çështje të përputhshmërisë së legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit European (acquis e BE-së).
- Të përgatisë opinion ligjor për Kryetarin dhe anëtarët e komisionit të ccështjeve europiane, për çdo projektligj, që i paraqiten Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, i cili synon përafrim me instrumentet ligjore të BE-së, duke dhënë mendimin e tij për: përputhshmërinë e tyre me acquis të BE-së, shkallën e përputhshmërisë së tyre me aktet ligjore të BE-së; përmirësim të përcaktimeve dhe formulimeve të propozuara (duke patur në konsideratë instrumentin ligjor të BE-së me të cilin synohet përputhshmëria).
- Të përgatisë opinion ligjor për Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për projekt-marrëveshjet që lidhen me institucionet e Bashkimit European dhe/ose me vendet e Bashkimit European, nëse projektligji nuk synon përafrim me legjislacionin e BE, por në fushëveprimin e tij ka acquis të BE-së.
- Të hartojë raporte përmbledhëse për ligjet e miratuara në Kuvend, që synojnë përafrimin me acquis e BE-së.
- Të koordinojë me të gjitha Shërbimet e tjera të Kuvendit, për mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit të nevojshëm dhe përpunimin e tij, për hartimin e të gjitha kontributeve që kërkojnë nga Kuvendi në kuadër të: i) takimeve të përbashkëta BE-Shqipëri (për zbatimin e MSA-së/ nënkomiteteve BE-Shqipëri / Drejtësi, Liri dhe Siguri (JFS); Kapitulli 23;. ii) të gjitha raportimeve apo hartimit të dokumenteve që kërkojnë në kuadër të procesit të negociatave, ku Kuvendi është në pozicionin e institucionit raportues (Kapitulli 23, Kriterin

- Politik etj); iii) Planit Kombëtar të Integritimit European (PKIE); iv) Agjencisë për të Drejtat Themelore (FRA).
- Mbledh dhe përpunon bazën e të dhënave për veprimtarinë e Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit si dhe të të dhënave në kuadër të raportimeve për procesin e integritimit european, për të cilat është përgjegjëse kjo strukturë.
- Të bashkëpunojë dhe të informojë në mënyrë të vazhdueshme Drejtorin e Shërbimit të Përafrimit dhe të zbatojë detyrat e ngarkuara prej tij.
- Të bashkëpunojë me relatorin e komisionit për çështjet europiane për përgatitjen e relatimit për projektligjet që shqyrtohen nga ky komision.
- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme mbledhjet e Komisionit për Çështjet Europiane si dhe në komisionet e tjera parlamentare dhe informon drejtorin e Shërbimit të Përafrimit mbi amendimet që prekin nenet e përafruara të projektligjeve që janë miratuar nga Komisioni për Çështjet Europiane.

Marrëdhëniet organizative

Këshilltari jurist në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, përgjigjet përpara Drejtorit të Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit dhe përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Integritimit European sipas rastit.

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në nivelin “nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese”;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë, të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- d) të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurim

Kriteret e vendit të punës:

- Të ketë diplomë universitare DND; DIND (Bachelor + Master shkencor), në Shkenca Juridike;
- Preferohet të ketë kryer edhe studim pasuniversitar në të drejtën europiane;
- Të ketë eksperiencë pune të paktën 7 vjeçare, në hartimin dhe analizën e legjislacionit shqiptar dhe legjislacionit të Bashkimit europian.
- Të ketë aftësi për të kryer ekspertizë dhe analiza ligjore të standardit të lartë në fushën e legjislacionit europian.
- Të ketë aftësi në drejtim dhe komunikim (të shkruar dhe të folur), aftësi për të punuar në grup, aftësi për të kryer kërkime, analiza;
- Të ketë aftësi shume të mira në përdorimin e kompjuterit dhe programeve të aplikimit si paketa Microsoft Office etj,
- Të zotërojnë aftësi praktike në përballimin e situatave që kërkojnë angazhim të lartë dhe zgjidhje të shpejta praktike.
- Të ketë njohuri të konsoliduara të gjuhës angleze, niveli C1 të dëshmuar në përputhje me udhëzimin nr.52 datë 03.12.2015 të Ministrisë së Arsimit për përcaktimin e niveleve të

gjuhëve të huaja, ose dokumenteve zyrtarë të lëshuara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës me notë mbi tetë (tetë), ose dokumenteve që dëshmojnë përfundimin e studimeve në gjuhën angleze. Niveli i anglishtes do të testohet gjatë intervistës me shkrim dhe me gojë. Njohuri në gjuhë të tjera të Bashkimit Europian përbëjnë avantazh.

ç) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve të Kuvendit (Njësia Përgjegjëse), këto dokumente; letër motivimi për aplikim në vendin vakant, një kopje të jetëshkrimit (C.V), fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, fotokopje e listës së notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar, një fotokopje e librezës së punës e plotësuar, vërtetim i gjendjes gjyqësore, certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme, fotokopje e letërnjoftimit, aktin e deklaramentit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të mesëm drejtues, vërtetimin që nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe formularin e vlerësimit të gjashtë mujorit të fundit.

d) Afati i dorëzimit të dokumentave është **data 14.10.2024**, (10 dhjetë) ditë kalendarike nga moment i shpalljes në portal.

dh) Në datën **15.10.2024**, do të shpallet lista e vlerësimit të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin (në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë ata që plotësojnë kushtet minimale të lëvizjes paralele dhe kushtet e veçanta, të kërkuara më sipër. Kandidatët e skualifikuar do të njoftohen me telefon ose e– mail.

-Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

e)Konkurrimi- intervista me gojë do të bëhet **në datën 22.10.2024**, në mjediset e Kuvendit, në orën **10:00**.

ë) Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, ligjin “Për nëpunësin civil”, Kodin e Procedurave Administrative si dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

f) Kandidatët do të vlerësohen nga “Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele” (KPLP), i ngritur pranë Institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. **Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht: 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20**

pikë përvojën, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv apo për vlerësimin e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer **dhe 60 pikë për intervistën me gojë.**

g) Njësia përgjegjëse (Burimet Njerëzore) do të njoftojnë kandidatët për rezultatin e konkurrimit, në mënyrë individuale me telefon ose e-mail.

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimi për Lëvizjen Paralele” (KPLP), brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

gj) Lista e fituesve me 70 pikë e lartë (70% të pikëve e lartë) do të shpallet në datën 28.10.2024, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numër telefoni +35542278270 dhe +35542278425, ose në adresën: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.4, Tiranë.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të kategorisë së mesme drejtuese, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

Në se nga procedura e mësipërme nuk shpallet anjë fitues, konkurrimi do të vazhdojë me procedurë si më poshtë:

B- Ngritja në Detyrë.

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kreut V , “Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, nenit 26 “Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese”, vendimit të Byrosë nr.52 “për disa shtesa dhe ndryshime në strukturën e Administratës së Kuvendit” datë 26.06.2023, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, kreut II, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, njofton se:

Në Administratën e tij ka 2 (dy) vende të lira pune, në pozicionin: “këshilltar jurist” në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, pranë Shërbimit të Integrimit European

c) Kategoria e pagës II, klasa I-5

Qëllimet pozicionit të punës:

Të mbështesë në mënyrë efektive, me ekspertizë juridike të një standardi të lartë dhe profesionalizëm, Kuvendin e Shqipërisë, në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European (acquis e BE-së).

d) Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Të përgatisë mendimin e specializuar juridik të kërkuar nga Drejtori i Shërbimit të Përafrimit për çështje të përputhshmërisë së legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit European (acquis e BE-së).
- Të përgatisë opinion ligjor për Kryetarin dhe anëtarët e komisionit të ccështjeve europiane, për çdo projektligj, që i paraqiten Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, i cili synon përafrim me instrumentet ligjore të BE-së, duke dhënë mendimin e tij për: përputhshmërinë e tyre me acquis të BE-së, shkallën e përputhshmërisë së tyre me aktet ligjore të BE-së; përmirësim të përcaktimeve dhe formulimeve të propozuara (duke patur në konsideratë instrumentin ligjor të BE-së me të cilin synohet përputhshmëria).
- Të përgatisë opinion ligjor për Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për projekt-marrëveshjet që lidhen me institucionet e Bashkimit European dhe/ose me vendet e Bashkimit European, nëse projektligji nuk synon përafrim me legjislacionin e BE, por në fushëveprimin e tij ka acquis të BE-së.
- Të hartojë raporte përmbledhëse për ligjet e miratuara në Kuvend, që synojnë përafrimin me acquis e BE-së.
- Të koordinojë me të gjitha Shërbimet e tjera të Kuvendit, për mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit të nevojshëm dhe përpunimin e tij, për hartimin e të gjitha kontributeve që kërkojnë nga Kuvendi në kuadër të: i) takimeve të përbashkëta BE-Shqipëri (për zbatimin e MSA-së/ nënkomiteteve BE-Shqipëri / Drejtësi, Liri dhe Siguri (JFS); Kapitulli 23;. ii) të gjitha raportimeve apo hartimit të dokumenteve që kërkojnë në kuadër të procesit të negociatave, ku Kuvendi është në pozicionin e institucionit raportues (Kapitulli 23, Kriterin Politik etj); iii) Planit Kombëtar të Integritimit European (PKIE); iv) Agjencisë për të Drejtat Themelore (FRA).
- Mbledh dhe përpunon bazën e të dhënave për veprimtarinë e Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit si dhe të të dhënave në kuadër të raportimeve për procesin e integritimit european, për të cilat është përgjegjëse kjo strukturë.
- Të bashkëpunojë dhe të informojë në mënyrë të vazhdueshme Drejtorin e Shërbimit të Përafrimit dhe të zbatojë detyrat e ngarkuara prej tij.
- Të bashkëpunojë me relatorin e komisionit për çështjet europiane për përgatitjen e relatimit për projektligjet që shqyrtohen nga ky komision.
- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme mbledhjet e Komisionit për Çështjet Europiane si dhe në komisionet e tjera parlamentare dhe informon drejtorin e Shërbimit të Përafrimit mbi amendimet që prekin nenet e përafruara të projektligjeve që janë miratuar nga Komisioni për Çështjet Europiane.

Marrëdhëniet organizative

Këshilltari jurist në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, përgjigjet përpara Drejtorit të Shërbimit të Përafrimit të Legjislacion dhe përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Integritimit European sipas rastit.

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- e) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në nivelin “nëpunës civil i kategorisë së ulët drejtuese”;
- f) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- g) të ketë, të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- h) të plotësoj kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurim

Kriteret e vendit të punës:

- Të ketë diplomë universitare DND; DIND (Bachelor + Master shkencor), në Shkenca Juridike;
- Preferohet të ketë kryer edhe studim pasuniversitar në të drejtën europiane;
- Të ketë eksperiencë pune të paktën 7 vjeçare, në hartimin dhe analizën e legjislacionit shqiptar dhe legjislacionit të Bashkimit europian.
- Të ketë aftësi për të kryer ekspertizë dhe analiza ligjore të standardit të lartë në fushën e legjislacionit europian.
- Të ketë aftësi në drejtim dhe komunikim (të shkruar dhe të folur), aftësi për të punuar në grup, aftësi për të kryer kërkime, analiza;
- Të ketë aftësi shume të mira në përdorimin e kompjuterit dhe programeve të aplikimit si paketa Microsoft Office etj,
- Të zotërojë aftësi praktike në përballimin e situatave që kërkojnë angazhim të lartë dhe zgjidhje të shpejta praktike.
- Të ketë njohuri të konsoliduara të gjuhës angleze, niveli C1 të dëshmuar në përputhje me udhëzimin nr.52 datë 03.12.2015 të Ministrisë së Arsimit për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja, ose dokumenteve zyrtarë të lëshuara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës me notë mbi tetë (tetë), ose dokumenteve që dëshmojnë përfundimin e studimeve në gjuhën angleze. Niveli i anglishtes do të testohet gjatë intervistës me shkrim dhe me gojë. Njohuri në gjuhë të tjera të Bashkimit Europian përbëjnë avantazh.

ç) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve të Kuvendit (Njësia Përgjegjëse), këto dokumente; letër motivimi për aplikim në vendin vakant, një kopje të jetëshkrimit(C.V), vendimin e konfirmimit si nëpunës civil, fotokopje e diplomës nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, fotokopje e listës së notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar, një fotokopje e librezës së punës e plotësuar, vërtetim i gjendjes gjyqësore, certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme, fotokopje e letërnjoftimit dhe aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues, vërtetimin që nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe formularin e vlerësimit të gjashtë mujorit të fundit.

d) Afati i dorëzimit të dokumentave është **data 19.10.2024.**

dh) Në datën **29.10.2024**, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin (në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë ata që plotësojnë kushtet minimale të ngritjes në detyrë dhe kushtet e veçanta, të kërkuara më sipër.Kandidatët e skualifikuar do të njoftohen me telefon ose e- mail.

-Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, **brenda 3 ditëve kalendarike** nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje **brenda 5 ditëve kalendarike** nga data e depozitimit të saj.

e) Konkurrimi- testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë, do të zhvillohet në **datën 06.11.2024**, në mjediset e Kuvendit, në orën **10:00**.

Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, ligjin “Për nëpunësin civil”, Kodin e Procedurave Administrative si dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

f) Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë**, i ngritur pranë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. **Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht: 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar (ekspierencë, trajnime, kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, si dhe 2 vlerësimet e fundit pozitive); 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë dhe 40 pikë për vlerësimin me shkrim.

g). Kandidatët do të njoftohen me telefon ose e- mail.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, **brenda 3 ditëve kalendarike** nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje **brenda 5 ditëve kalendarike** nga data e depozitimit të saj.

gj) Shpallja e fituesit do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut, **në datën 11.11.2024**.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numër telefoni +35542278270 dhe +35542278425, ose në adresën: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.4, Tiranë.